

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E FINANCAVE
KABINETI

URDHER

I

AKSIONISTIT TE VETEM TE SHOQERISE ANONIME
BUKA

TIRANE

Nr.32/1 date 29/1/1996

Me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise anonime BUKA TIRANE, cilesi kete qe e kam ne baze te paragrafit te dyte te nenit 3 te Ligjit Nr.7926, date 20.4.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" dhe ne baze te nenit 128 te Ligjit 7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare";

Urdheroj:


1. Ne aktet e themelimit te shoqerise anonime BUKA TIRANE te behen ndryshimet e meposhtme:

Ne kapitalin themeltar te shoqerise te shtohet vlere e truallit prej 37,504,000 leke dhe numri i aksioneve 37,504 si dhe me nje siperfaqe prej 41,070 m². Keto ndryshime te behen ne piken 4 te Aktit te Themelimit dhe ne nenin 3 te Statutit te Shoqerise.

2. Vleresimi i truallit, qe do te behet shtese ne kapital sipas pikes se mesiperme, te behet sipas dispozitave ne fuqi.

3. Ngarkohet Drejtoria e Shoqerive Publike te beje veprimet perkatese per shtimin e kapitalit ne perputhje me parashikimet e nenit 33 te Ligjit Nr.7667 "Per rregjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen kryer ne te".

MINISTRI
DYLBER VRIONI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA ANONIME "BUKA"
NR. 934 Prot.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 21. Rep. Dt. 04.05.1999

VERBETIM

Vërtetohet se fotokopja është e
njëjtë me origjinalin. Dokumenti
u paraqit nga *Mirëdy Senad*
Nr. Pasap *2200*

NOTERE
SHOQERIA ANONIME "BUKA"
TIRANE



Tirane.me 10.5.1999

VERBAL NR 3

Mbledhjes se Asamblese se Zakonshme te Aksionereve te

SHOQERISE ANONIME "BUKA" SH.A.



Ne daten 8.V.1999 ne Fabriken e Bukes u zhvillua mbledhja e
Asamblese se Zakonshme te Aksionereve e thirrur me shkresen e drejtorit
Nr. 925 date 25.4.1999.

Merrnin pjese Kryetari i Asamblese Zoti Petrit Pecani, Drejtori i
Përgjitheshem i Shoqerise si dhe Asambleja e Aksionereve.

Merrnin pjese gjithashtu dhe zoterinjte Mirton Hajdini dhe Ali
Balluku anetare te Keshillit Mbikqyres me cilesine e përfaqesuesit te
pronarit (zoterues i 51 %) te aksioneve si dhe Zoti Sokol Sulaj përfaqes
- es i aksionereve pra i 49 % .

Rendi i Dites i mbledhjes i përcaktuar ne shkresen Nr 925 ishte;

1. Raport mbi aktivitetin ekonomik - financiar dhe administrimin e
prones për vitin 1998 dhe programin ekonomik - financiar për vitin 1999.
2. Bilancin e llogarive vjetore te vitit 1998
3. Raportin e llogarive vjetore dhe verifikimin e tyre nga ekspertet
kontabel.
4. Miratimi i eksperteve kontabel për vitin 1998.
5. Probleme te tjera.

- Për piken Nr 1 te Rendit te dites Raportin e mbajti Z. Abdyl Sinani
Drejtor i Përgjitheshem;
- Për piken Nr 2 te Rendit te Dites Raportin e mbajti Znj. Nazmie
Balla, shefe e finances.

Për piken Nr 3 te Rendit te Dites referoi Zoti Kole Gjoni
ekspert kontabel i autorizuar.



Mbas pyetjeve dhe diskutimeve Asambleja vendosi ;

I . Te miratoje Raportin e Drejtorit te përgjitheshem për aktivitetin ekonomik - financiar dhe administrimin e prones për vitin 1998 , llogaritë vjetore si dhe raportin e ekspertëve kontabel dhe aprovoi projekt programin ekonomik - financiar për vitin 1999.

II. Drejtoria e S.E.A. " BOKA " sipas sugjerimit te bere nga ekspertet kontabel i propozon asamblese se zakoneshme te aksionereve dhe Keshillit Mbikqyres zvogelim kapitali për humbjen e ardhur nga djegjet dhe shkatërrimet e vitit 1997 dhe diferencen e Dabi - Kredive tevjetra ne masen prej **44.660.000 Leke.**

- Asambleja e Aksionereve dhe Keshilli Mbikqyres ishin dakort unanimitet qe Kapitali Themeltar i rregjistruar ne Gjykate te ulet ne vleren e propozuar prej **44.660.000 Leke .**

III. Sipas shkreses Nr. 1574/4 date 27.4.1999 te Ministrise Publike dhe Privatizimit dhe me sygjerrim te Keshillit Mbikqyres ju propozua për miratim Asamblese se Aksionereve kerkesa e Firmes " INJAG "Sh.P.K. Tirane për qeramarrije te Fabrikes se prodhimit te Majase.

- Asambleja e Aksionereve dhe Keshilli Mbikqyres vendosi t'ja jape me qera Fabriken e Majase Firmes " INJAG " Sh.p.k. Tirane.

IV. Megenese Asambleja e Aksionereve miratoi zvogelimin e Kapitalit Themeltar te rregjistruar ne Gjykate,i propozohet asaj nga Drejtoria e Ndemarjes kjo ndarje fitimi për vitin 1998.

Fitimi i Bilancit	4.970.559 ⁸⁰
Rezerva e domosdoshme	248.528
Dividenti	4.722.032

- Asambleja e Aksionereve dhe Keshilli Mbikqyres aprovuan shifrat e mesipërme për ndarjen e fitimit te vitit 1998.

V. U miratua propozimi i drejtorit te përgjitheshem për te lene ne kompetence te Keshillit Mbikqyres caktimin e dy ekspertëve kontabel për vitin 1999, ne përshtatje te ndryshimeve ligjore dhe administrative qe beken nga organet kompetente ne lidhje me funksionet dhe listen e tyre.

U miratua mundësia e lidhjes dhe e bashkepunimit me ndonjë firmë te huaj ne Fabrikën Nr 1 për prodhim të biskotërive të ndryshme ose prodhimeve të tjera të brumit.

VII. U miratua mundësia e përfjes së linjave të reja të bukes për prodhim buke dhe asortimentesh.

VIII. Te vazhdohet dhënia e magazinave me qera, por si edhe tani me pagesë fikse.

IX. U miratua të blihet në ankand nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe N.T.G. Durrës, grure dhe të shitet ai fabrikave të miellit. Kjo të bëhet me kusht që me këtë biznes të rezultoi me fitim 2 - 4 Dolla për 1 Ton. Gjithashtu edhe për të siguruar vazhdueshmëri në furnizimin me miell dhe çmime që të përballohet kostua e bukes.

PËR ASAMBLENËN E ZAKONESHME

SEKRETARJA

/ Artë Saraçi /

MIRTON

SOKOL

ALI

HAJDINI

SULAJ


BALLUKU

DREJTORI I PËRGJITHËSHËM

ABDYL

SINANI

NOTERE
ARTEMISA MECAJ
TIRANË



/ Petrit /

KRYETAR

N/ KRYETAR

ANETAR



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SH.A."BUKA" TIRANE
Nr. 94 Prot.



Tirane, me 26.04.2000

PROCES VERBAL NR. 4

I MBLEDHJES SE JASHTEZAKONSHME TE AKSIONEREVE TE SH.A."BUKA" TIRANE

Me date 26.04.2000 ne seline e Sh.A."Buka" Tirane, Rruga e Kavajes, u zhvillua mbledhja e jashtezakonshme e Shoqerise e thirrur nga Drejtori i Pergjithshem nepermjet shkreses nr.19/1 date 11.4.2000.

Mbledhja u drejtua nga Kryetari Asamblese se Aksionereve Z.Petrit Pecani nen pranine e sekretares Zj. Arta Saraci.

Nen cilesine e perfaqesuesit te zoteruesit te 51 % te paketes shteterore te aksioneve te Sh.A. "BUKA" Tirane ishte zoti Mirton Hajdini , sipas autorizimit Nr 3131/1 date 20.04.2000 .

Mbledhja u zhvillua nen pranine e Drejtorit te Pergjithshem te shoqerise z.Abdyl Sinani si dhe te aksionereve te shoqerise qe zoterojne mbi 73 % te kapitalit (kjo sipas evidences bashkengjitur procesverbalit).

Asambleja e Jashtezakonshme u mblodh per te shqyrtuar rendin e dites te percaktuar ne shkresen nr. 19/1 date 11.4.200 e cila kerkon miratimin per zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise per humbjet e shkaktuara nga djegjet dhe shkaterrimet e marsit 1997 .

U paraqit raporti i eksperteve kontabel nr. 58/1 date 10.03.2000 te cilet japin vleresimin e tyre mbi shkaqet dhe kushtet e zvogelimit.

Pasi pjesmarresit ne mbledhje drejtuan pyetje dhe diskutuan rreth ketij problemi, u procedua me hedhjen ne votim.



Me vota unanime u pranua propozimi i Drejtorit te Pergjithshem te Sh.A. "BUKA"
Z.Abdyl Sinani, per zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise ne vleften 44.660.000
Leke dhe ndryshimet perkatese ne Statutin e Shoqerise.

Per kete Asambleja e Jashtezakonshme ngarkoi Drejtorin e pergjithshem te Shoqerise qe
te ndjekte procedurat e paraqitjes se kerkeses ne Gjykatën e Rrethit Tirane per aprovimin e
zvogelimit te kapitalit dhe Rregjistrimin e tij ne Rregjistrin Tregetar.



SEKRETARJA

KRYETARI I ASAMBLESE

/ ARTA SARACI /

/ PETRIT, PECANI /

[Signature]

[Signature]

EVIDENCA E PJESEMARRJES

(Ne % ne Kapitalin e Ndermarjes)

MYRTON



51 % i Shtetit

ARBEN BESHIRI	9.25	SOKOL SULAJ	0.054
ARBEN VAQARI	3.598	FLUTURA POGA	0.085
PETRIT PECANI	2.741	ABDYL PUKA	0.224
NIKOLLA DEDE	1.168	ISMAIL KRUTANI	0.067
LIDIA BENUSI	0.444	ARTA HOXHA	0.067
AGIM LAHI	0.283	REFIJE TRIMI	0.080
ENGJELL. PIRGU	0.269	RASIM YMERI	0.067
ATIJE KRASNIQI	0.426	BEQIR FAGU	0.116
ELENI BULI	0.233	BARDHYL SHIMA	0.067
PANDORA POPE	0.597	SULEJMAN ELMAZAJ	0.067
ZAIT LAHI	0.359	DHIMITRAQ LONDO	0.067
MIRANDA HUTA	0.175	VJOLLCA KRUTANI	0.067
VASILIKA BULLACI	0.098	GEZIM LIKA	0.067
TAHIR CUKU	0.098	SHPRESA YMERI	0.067
YLLI CAUSHLLARI	0.098	VJOLLCA ALIAJ	0.044
MUHAMET BEQIRI	0.093	BESNIK ZHURDA	0.067
SELMAN PAJA	0.083	AFERDITA JONUZI	0.067
BURHAN KRIFSA	0.134	SHPRESA SHEVROI	0.067
LEFTONI PASHOLLARI	0.089	XHILDA KASMI	0.067
QERIME SALA	0.067	AGIM CULLHAJ	0.044
HENA GARAJ	0.075	AISHE SELMANI	0.067
BILBIL KASMI	0.067	DALLANDYSHE PINARI	0.044
MARJANA VUCAJ	0.057	DRITAN SHKURTI	0.044